



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

13 -01- 2021

Ref. 2101/014/BA/Yf

Nr. 01/2021

Bordi për Ankesa (BA), i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën Nr. Ref.2012/957/BA/nr të datës 07.12.2020 të parashtresit “Radio Televizioni i Kosovës RTK “, të paraqitur ndaj Vendimit Ref: 2011/836/KPM/xhl, të datës 30.10.2020 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datë 06.01.2021 mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa Nr. Ref.2012/957/BA e datës 07.12.2020 e parashtresit “Radio Televizionit të Kosovës RTK”.

ANULOHET Vendimi me numër Ref: 2011/836/KPM/xhl, i datës 30.10.2020 i Komisionit të Pavarur të Mediave dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Nr. Ref: 2011/836/KPM/xhl, të datës 30.10.2020, e ka sanksionuar me Vërejtje RTK, si pala përgjegjëse në pajtim me nenin 30 paragrafi 1, të ligjit të KPM-së për shkelje të nenit 5 të paragrafit 2 dhe 5 nenin 6 të paragrafit 1, si dhe në nenin 7 të paragrafit 6, të Kodit të Etikës së KKPM-2016/03.

Kundër këtij vendimi në afatin e paraparë ligjor Radio Televizioni i Kosovës RTK me datë 07.12.2020 ka parashtruar ankesë pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: Vërtetimit plotësisht të gabuar të gjendjes faktike, mos arsyetim të vendimit dhe gabimeve procedurale dhe materiale, duke mos analizuar provat gjatë marrjes së vendimit me propozim që Bordi për Ankesa të aprovojë ankesën e palës përgjegjëse dhe të ndryshojë vendimin e Komisionit të Pavarur për Media me nr.ref 2011/836/KPM/xhl dhe të vlerësohet si e pa bazuar në tërësi dhe të anulohet vendimi e kundërshtuar apo të shfuqizoj dhe çështja ti kthehet në shqyrtim, Komisionit të Pavarur për Media me udhëzimin për të evidentuar shkeljet eventuale.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datë 06.01.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Radio Televizionit të Kosovës”, Bordi për Ankesa ka konstatuar se qëndrimet ankimore të Palës ankuese kundër Vendimit Ref: 2011/836/KPM/xhl, të datës 30.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të qëndrueshme dhe të bazuara pasi që në vendimin e KPM-së nuk janë analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat siç parashihet në nenet 86, 88 dhe 89 Ligjin e Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bordi për Ankesa konstaton se përderisa ka shkelje procedurale gjatë marrjes së Vendimit nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave nuk mund të lëshohet në administrimin e provave. Pra Bordi për Ankesa ka konstatuar se të metat e cekura në vendimin e KPM-së janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë të atij vendimi dhe KPM gjatë rishqyrtimit të lëndës duhet të vërtetoj plotësisht gjendjen faktike dhe të bëjë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe të mënjanoj shkeljet eventuale.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1, i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2, i Rregullores Nr. BA 2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



Xhaver Fetahaj
Kryetar i Bordit për Ankesa